



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:188826

Datë: 10.01.2025

Numri i dokumentit: 06697568

C.nr.2725/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.F nga Vushtrria, të cilin e përfaqëson K.F avokat nga Prishtina, rruga “...” 36/4, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e kualifikimit arsimor dhe kompensim mbi bazën e përvojës së punës, jashtë seance me datë 10.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET së është tërhequr padia me numër C.nr.2725/24 e datës 06.06.2024, e paditësit E.F nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, lidhur me çështjen kontestimore-pagesa mbi bazën e kualifikimit arsimor dhe kompensim mbi bazën e përvojës së punës.

A r s y e t i m

Paditësi E.F nga Vushtrria, të cilin e përfaqëson Av. K.F nga Prishtina, rruga “...” 36/4, me datë 06.06.2024, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, për pagesën mbi bazën e kualifikimit arsimor dhe kompensim mbi bazën e përvojës së punës, në shumën prej 2,896.74 euro.

Përfaqësuesi i paditësit, me parashtresën e datës 20.12.2024, e ka njoftuar gjykatën se shqyrtimi i mëtejme i padisë është i panevojshëm dhe i paarsyeshëm, andaj e tërheqë padinë në këtë çështje kontestimore.

Numri i lëndës: 2024:188826
Datë: 10.01.2025
Numri i dokumentit: 06697568

Gjykata, në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.2725/24, me datë 10.01.2025

Gj y q t a r i
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.